



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 273 Prot.

Roskovec, më 16.01.2023

NJOFTIM  
PËR

**VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN “SANITARE” NË ÇERDHEN PUBLIKE  
BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 23.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse për vitin 2023”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 02/1 prot. datë 06.01.2023, si dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 11, datë 16.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, për vitin 2023”,

**Bashkia Roskovec shpall 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Sanitare” në Çerdhen Publike Roskovec.**

**A. Disa nga detyrat funksionale të “Sanitares të Çerdhes” janë:**

Është punonjës në varësi të Përgjegjës të Çerdhes. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

1. Pastron me një higjenë të lartë gjithë mjediset e brendshme dhe të jashtme të çerdhes (korridoret, grupet e fëmijëve, tualetet, zyrat, oborri etj).
2. Ndjek me rigorozitet dhe pastrimin e mjedisit të kuzhines së çerdhes.
3. Zbaton detyrat dhe udhëzimet që i jep Përgjegjësja e Çerdhes dhe edukatorja e grupit.
4. Kujdeset për larjen e materialeve të buta.
5. Kujdeset për mirëmbajtjen e luleve në mjediset e brendshme dhe të jashtme të çerdhes.
6. Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të institucionit.
7. Të zbatojë orarin zyrtar, disiplinën dhe etikën profesionale në punë.
8. Zbaton dhe detyra të tjera të ngarkuara nga Përgjegjësi i Çerdhes.

**B. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:**

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Vërtetim banimi
- Çertifikatë personale dhe familjare
- Deftesë/Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
- Librezë pune origjinale
- Raport mjeko – ligjor
- Dëshmi penaliteti

**Afati i fundit i paraqitjes së aplikimeve është më datë 24.01.2023.**

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Sektorin e Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë Roskovec.

**KRYETARI**  
**Majlinda Buri**